



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME / SPECIJALNA KOMORA VRHOVNOG SUDA / SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT  
 Pallati i Drejtësisë, Objekti A, Rruga Nekibe Kelmendi, 10510 Hajvali / Palata Pravde, Objekt A, Ulica Nekibe Kelmendi, 10510 Hajvali / Palace of Justice, Building A, Nekibe Kelmendi Street, 10510 Hajvali

VËRTETIMI MBI DORËZIMIN E DOKUMENTIT

POTVRDA O DOSTAVI DOKUMENTA

ACKNOWLEDGEMENT OF RECEIPT OF A DOCUMENT

Duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, pala e nënshkruar më poshtë vërteton pranimin e dokumentit:

Na osnovu Zakona br. 04/L-033 o Specijalnoj komori Vrhovnog suda Kosova za pitanja koja se odnose na Kosovsku agenciju za privatizaciju, dole potpisana stranka potvrđuje dostavu dokumenta navedenog dole:

Pursuant to Law no 04/L-033 on Special Chamber of the Supreme Court of Kosovo on Privatization Agency of Kosovo Related Matters, the below signed party acknowledges receipt of the document described below:

Numëri i lëndës: Broj predmeta: Case Number:

**C-IV.-15-1607**

Data e regjistrimit: Datum registrovanja: Date registered:

**16/10/2015**


Paditës  
Tužilac  
Claimant

Përfaqësues  
Punomočnik  
Representative

I paditur  
Tuženi  
Respondent

Përfaqësues  
Punomočnik  
Representative

#	Titulli i Dokumentit:	Naziv dokumenta:	Document Name:	Datë Datum Dated
1	Udhëzim nga Gjykatësi	Instrukcija sudije	Direction of the Judge	15/10/2015



Pala: Stranka: Party:

**1. Agjencia Kosovare e Privatizimit**

Authority • Privatization • Ilir Konushevci 8, Prishtinë

Pranuar nga: Primio: Received by:

Titulli: Zvanje: Title:

Data: Datum: Date:

Nënshkrimi Potpis: Signature:

*Mysnet Beku*  
*Izeta Lijpi*  
*16/10/2015*  
*Bekunaj*

Në bazë të nenit 25.8 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033, të gjitha parashtresat dhe dokumentet mbështetëse duhet të paraqiten ose në gjuhën shqipe ose në gjuhën serbe dhe të shoqërohen edhe me përkthimin në gjuhën angleze.

Na osnovu člana 25.8 Dodatka Zakona br. 04/L-033, svi podnesci i prateći dokumenti moraju da budu podneseni na albanskom ili srpskom jeziku zajedno s prevodom na engleski jezik.

Pursuant to Section 25.8 of the Annex of the Law no 04/L-033, all pleadings and supporting documents must be submitted either in Albanian or in Serbian accompanied by an English translation.





C-IV-15-1607

15 tetor 2015

*Parashtrues i kërkesës*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit – Prishtinë**  
**Rr. "Ilir Konushevc", nr.8**

**Për: Parashtruesin e kërkesës**

Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, Kolegji i Specializuar nr. V, i përbërë nga gjyqtaret , Hysen Gashi kryesues i kolegjit, dhe Arkadiusz Semeniuk e Cerim Fazliji antarë, në seancën vendimarrëse të mbajtur me 15 tetor 2015 leshonë këtë:

**U D H Ë Z I M**

- I. Nga data e parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim, e deri në përfundimin e Likuidimit PEZULLOHET çdo procedurë gjyqësore, administrative apo e arbitrazhit që është kundër ndërmarrjes dhe asetëve të saj që është subjekt i Vendimit për Likuidim, përfshirë edhe procedurat përmbarimore të vendimeve të formës së prerë lidhur me kërkesat monetare.**
- II. Pezullimi i Procedurave nuk aplikohet në rastet e parapara me paragrafin 3 të nenit 10 të Shtojcës së Ligjit (nr. 04/L-034) për AKP-në.**
- III. Procedurat e Pezulluara mund të lejohen të vazhdojnë vetëm me miratimin e kërkesës nga Dhoma e Posaçme**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 06 tetor 2015 Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ka parashtruar kërkesë për udhëzim dhe nga Dhoma e Posaçme ka kërkuar që të jepet një udhëzim lidhur me çështjen se a kanë të drejt ligjore Gjykata Përmbarimore, Përmbaruesit Privat si dhe institucionet bankare ne Republikën e Kosovës që të ekzekutojnë pagesa të fondeve në mirëbesim sa i përket Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat janë në procedure të Likuidimit nga ana e AKP-së.

Në kërkesë kanë theksuar se një udhëzim i tillë, është i nevojshëm për Agjensinë, në mënyrë që të ndërmarrin veprime të mëtutjeshme në kuadër të trajtimit të kërkesave të ndryshme me karakter përmbarimor të cilat kohëve të fundit çdo dite e më tepër janë duke u bere kundër fondeve të NSH-ve të cilat administrohen nga AKP-ja. Kërkesës ja kanë bashkangjitur edhe disa propozime për përmbarim të parashtruara nga përmbaruesit privat, kundër NSH-ve që janë në procedurë të Likuidimit dhe udhëzimi është kërkuar në rastet e likuidimit të NSH "Beton" në Gjilan dhe NSH KBI "Malishgani" në Klinë.

## Arsyetimi ligjor



Kolegji i Specializuar pas pranimit të kërkesës, konstatoi se kërkesa është e pranueshme, andaj të njëjtën e muarr në shqyrtim.

Kolegji mendon se Dispozitat e nenit 10 të shtojcës së Ligjit të AKP-së, edhe pse janë të qarta dhe të kuptueshme, ato gjate aplikimit në praktikë në raaste të ndryshme, mundë të krijojnë hezitim ( edhe pse nuk do të duhej ), andaj dhe e pa të arsyeshëm lëshimin e këtij udhëzimi.

Duke mos i përshkruar dispozitat e këtij neni Kolegji konstaton se interpretimi i drejtë i këtyre dispozitave nënkupton se kur bëhet fjalë për procedurat gjyqësore, administrative, të arbitrazhit por edhe procedurat përmbarimore, që janë të drejtuara kundër ndërmarrjeve dhe asetëve të tyre që janë subjekt i vendimit të likuidimit, këto procedura pezullohen që nga data e parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim e deri me përfundimin e procedurës së likuidimit.

Zbatimi i këtij ligji është i obligueshëm jo vetëm për AKP-në dhe gjykatat por edhe për të gjitha institucionet e tjera, përfshirë edhe bankat si dhe përmbaruesit privat

AKP-ja, ka për detyrë që me rastin e pranimit të propozimeve të tilla kundër NSH-ve që janë në likuidim si në rastet që janë bashkangjitur kërkeses, të reagojë në kuadër të autorizimeve dhe kompetencave ligjore që i ka.

Ligji për AKP-në është Ligj i Posaqem (Lex Speciales) që zbatohet për rastet të tilla dhe përjashton zbatimin e të gjitha ligjeve të tjera të përgjithshme (Neni 31. par 1 i këtij ligji).

Andaj nga arsyerat e cekura me lartë dhe në bazë të nenit 48 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në u vendosë si në shqiptim të udhëzimit.

### Taksat Gjyqësore

Taksa gjyqësore është paguar me rastin e dorzimit të kërkesës.

### Kolegji i Specializuar

Hysen Gashi, gjyqtar kryesues

Arkadiusz Semeniuk, gjyqtar i Eulexit

Cerim Fazliji, gjyqtar

